

VENDIM
Nr. 496, datë 27.7.2022

**PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI AUTORITET
KONTRAKTOR PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË OBORRIT TË KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për zbatimin e projektit të oborrit të Kryeministrisë.

2. Në funksion të zbatimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratën përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e saj dhe të projektit përkatës;

b) paraqitjen, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, të kërkesave për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit pranë autoritetit të zhvillimit të territorit, si dhe ndjekjen e të gjitha veprimeve e procedurave të nevojshme për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Këtu përfshihet edhe marrja e miratimeve paraprake nga autoritetet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

3. Kryeministria i vendos në dispozicion Fondit Shqiptar të Zhvillimit paketën e projektit teknik, shoqëruar me preventivin, të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit.

4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit i paraqet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për të hartuar dhe ndërmarrë nismën për alokimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e projektit pranë tij.

5. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj